


RAPORT VJETOR 2025

Vendimi: Nr. **I/22**

Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2025 në mbledhjen Nr. 32 të mbajtur më datë 24.02.2026

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Agron STATOVCI Kryeshef Ekzekutiv	Jetmir NUKA Kryesuesi i BD
Nënshkrimi:	 	
Data:	11.02.2026	24.02.2026



trainkos

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2025



Fushë Kosovë,
Shkurt 2026

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	4
II.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
II.1.	Aktivitetet dhe performanca e Ndërmarrjes	6
II.2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden	8
II.3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë	8
II.4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve	9
III.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	11
III.1	Ngjarjet kryesore të vitit	12
IV.	PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE	12
IV.1.	Transporti i mallrave	13
IV.2.	Transporti i udhëtarëve	16
IV.3.	Mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse	18
V.	PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET	20
V.1.	Gjendja financiare	21
V.1.1.	Të hyrat	21
V.1.2.	Shpenzimet	21
V.1.3.	Të hyrat dhe shpenzimet operative	22
V.2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2025)	25
V.3.	Transaksionet e realizuara	25
V.4.	Bilanci i gjendjes	27
VI.	PROJEKTET KAPITALE DHE PROKURIMI	27
VII.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	34
VII.1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	34
VII.2.	Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH dhe institucionet tjera relevante	36
VII.3.	Aktivitetet e marketingut	37
VII.4.	Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore dhe Sekretariatit për Zbatimin e Traktatit për Transport	39
VIII.	STRUKTURA ORGANIZATIVE	40
IX.	PROCEDURAT GJYQËSORE	42
IX.1.	Kontestet gjyqësore	42
IX.2.	Tabela e kontesteve gjyqësore	51
X.	PËRFUNDIM	52
I.	ANEKS RAPORTI	
I.1	Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet	
I.2	Raport Vjetor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025	
I.3	Raport i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve për vitin 2025	

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2025, Ndërmarrja kishte një ecuri të njëjtë progresive, me vitin paraprak për realizimit e planit operativ dhe financiar, duke u ballafaquar me sfida shumë të mëdha, sidomos nga vonesat e ndodhura në realizimin e projektit për Modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, sesioni Jug (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Mirëpo, falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK-Trainkos Sh.A. është arritur që Ndërmarrja të arrij disa rezultate dhe të ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të Ndërmarrjes, të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2025. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e Ndërmarrjes bashkë me disa prej aktiviteteve të saj.

Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e Ndërmarrjes, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të Ndërmarrjes dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu, brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit, si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2025 i HK -Trainkos Sh.A., ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm si dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve për vitin 2025.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Në fillim të muajit janar të vitit 2024, Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. është emëruar dhe ka filluar ushtrimin e kompetencave të tij në përputhje me detyrat dhe obligimet që burojnë nga Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga legjislacioni tjetër përkatës për Ndërmarrjet Publike.

Gjatë kësaj periudhe, Bordi ka qenë i angazhuar me përkushtim të lartë për të arritur rezultate të prekshme në përputhje me objektivat e planifikuara dhe për të përmirësuar gjendjen e Ndërmarrjes, duke pasur parasysh sfidat që kanë rrjedhur nga problemet e trashëguara ndër vite. Këto probleme do të jenë sfiduese edhe gjatë vitit 2026.

Falë angazhimit të të gjithë drejtorëve dhe stafit menaxhues, kemi arritur sukseset e para në përmbushjen e obligimeve, duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e gjendjes. Gjatë vitit 2025, janë arritur përmirësime të dukshme, si rezultat i masave të marra për optimizimin e shpenzimeve dhe minimizimin e humbjeve, që ka kontribuar në përmirësimin e gjendjes financiare.

Për të adresuar sfidat dhe për të mundësuar një rritje të qëndrueshme, kemi hartuar dhe venë në zbatim planin strategjik afatmesëm si dhe kemi përfunduar procesin e ristrukturimit të Ndërmarrjes, pas një pune intensive, i cili ka filluar të zbatohet në fillim të vitit 2025.

Edhe pse nuk kemi arritur ende nivele të kënaqshme në realizimin e objektivave të planifikuara, sidomos në transportin e mallrave, përmbushja e obligimeve ligjore dhe angazhimi në zhvillimin e politikave strategjike kanë qenë prioritet i Bordit. Kjo ka mundësuar mbikëqyrjen e vazhdueshme të implementimit të këtyre politikave dhe një përpjekje të pandërprerë për të siguruar një qeverisje korporative sipas standardeve më të larta.

Në vijim, ky raport do të paraqesë detaje mbi aktivitetet dhe performancën e Ndërmarrjes për vitin 2025, si dhe informacione të tjera të rëndësishme.

II.1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2025 janë përqendruar në realizimin e objektivave të planifikuara dhe përpjekjet për tejkalimin e pengesave dhe vështirësive të Ndërmarrjes.

Një nga sfidat kryesore gjatë periudhës raportuese ka qenë gjendja e rëndë financiare, që vazhdon të mbetet një problem i madh, si dhe mbyllja e hekurudhës në Linjën e Hanit të Elezit. Ndërmarrja është përballur gjithashtu me obligime financiare të akumuluar ndër vite ndaj partnerëve dhe institucioneve të tjera, të cilat nuk kanë mundur të përmbushen, megjithatë gjatë vitit 2025 nuk janë krijuar obligime të reja.

Ndërprerjet e transportit hekurudhor për shkak të punimeve në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore kanë ndikuar në paralizimin e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve, duke përfshirë edhe transportin e mallrave për NewCo Ferronikeli-n. Në transportin vendor të udhëtarëve është mbajtur në operim vetëm Linja e Pejës me katër trena në ditë, dy në shkuarje dhe dy në ardhje.

Përkundër këtyre sfidave, Bordi i Drejtorëve është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të adresuar këto vështirësi dhe për të dalë nga kjo situatë, megjithatë këto vështirësi do të mbeten një sfidë edhe për të ardhmen.

Gjatë vitit 2025, Bordi është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve të auditorëve për gjetjet nga auditimi i vitit paraprak. Po ashtu, janë përgatitur dhe hartuar dokumente strategjike dhe politika tjera të cilat do të orientojnë zhvillimin e Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.

Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2025

Përkushtimi kryesor gjatë vitit 2025 ka qenë realizimi i objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit. Mirëpo, përkundër kësaj, objektivat e planifikuara nuk janë realizuar plotësisht për shkak të pengesave të lartpërmendura. Megjithatë, ka pasur përmirësime të dukshme në disa aspekte të aktivitetit të Ndërmarrjes krahasuar me vitin paraprak.

Për të arritur qëllimet, janë ndërmarrë veprime për të adresuar dhe tejkaluar pengesat që kanë ndikuar në performancën e Ndërmarrjes. Me Menaxherin e Infrastrukturës, janë zhvilluar takime dhe kontakte për të mundësuar që Linja e Hanit të Elezit të funksionojë gjatë punimeve, sipas një orari të përshtatshëm.

Po ashtu, hartimi dhe rishikimi i politikave të Ndërmarrjes ka vazhduar, duke pasur efekte pozitive në organizimin dhe strukturimin e brendshëm të punëve. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare ka qenë gjithashtu një prioritet i Bordit.

Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Për sa i përket performancës operative dhe financiare, viti 2025 nuk mund të konsiderohet një

vit i kënaqshëm për Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. Ndërkohë që janë shënuar disa përmirësime, mirëpo objektivat e planifikuara nuk janë arritur plotësisht.

Transporti i Mallrave

Performanca operative e financiare në transportin e mallrave nuk është arritur, qoftë në krahasim me planifikimin ashtu edhe në raport me realizimin nga viti paraparak, pasi që nuk ka pasur transport për shkak të mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore.

Transporti i Udhëtarëve

Krahasuar me vitin 2024, numri i udhëtarëve në vitin 2025 është për +19,293 më i lartë, apo shprehur në përqindje është për +28.07 % më shumë, ndërsa krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për -964 më i ulët, apo shprehur në përqindje -1.08 %. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për +19,542.78 € më i lartë apo +32.90 %, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për +8,938.78 € më të larta, apo +12.77 %.

Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e Ndërmarrjes

Një nga sfidat kryesore mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse. Mjetet aktuale janë të vjetra dhe kanë shpenzime të larta për mirëmbajtje dhe operim, që ndikojnë në rritjen e kostos së përgjithshme. Kjo është si pasojë e buxhetit të kufizuar të Ndërmarrjes.

Investimet në modernizimin e rrjetit hekurudhor janë të domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit, por këto investime duhet të shoqërohen edhe me investime në mjete lëvizëse, për të siguruar rritjen e efikasitetit dhe performancës operacionale.

Po ashtu, hartimi i politikave strategjike për zhvillimin e Ndërmarrjes mbetet një prioritet. Bordi është angazhuar për të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, për të dhënë shtytje projekteve dhe për t'i çuar ato drejt realizimit.

Një tjetër aspekt që kërkon vëmendje është përgatitja profesionale e kuadrove. Fokusi do të jetë në zhvillimin e iniciativave për hapjen e drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

Të priturat për vitin e ardhshëm

Një nga synimet kryesore për vitin 2026 është investimi në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe blerjen e mjeteve të reja. Ky është një mision i vështirë, por me mbështetje nga Aksionari dhe mundësitë për gjetjen e donatorëve dhe formave të tjera të financimit, shpresojmë që do të realizohet. Për këtë qëllim, bazuar në Planin Strategjik-Investiv si dhe në Strategjinë e Transportit Multimodal, do të angazhohemi për gjetjen burimeve për investime në mjetet lëvizëse krahas me zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore. Sfidat me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm do të jenë ndikuese edhe në arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2026. Problemet e ndërprerjes së transportit për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në Linjën e 10-të Hekurudhore do të jenë çështja më sfiduese për zhvillimin e punës dhe të projekteve të Ndërmarrjes. Po ashtu edhe obligimet e larta financiare të akumuluar ndërsa vite do të jenë sfiduese.

II.2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Gjatë vitit 2025, Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. nuk kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje të re kreditore, por vazhdojnë të mbajnë obligimet e marra nga marrëveshja kredituese e vitit 2022 me ish-Ministrinë e Financave. Kredia për likuiditetin e urgjencës së infrastrukturës vitale, në shumën e 364,963.00€, mbetet ende aktive dhe e papaguar.

Për sa i përket mjeteve të buxhetit të ndara për projektet kapitale nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2025, në shumën e 489,275.00€, ato janë shfrytëzuar në shkallën prej 57.65%. Këto projekte kanë kontribuar në mbajtjen në operim të lokomotivave dhe vagonëve ekzistues, të cilët janë në operim.

Sa i përket shpërndarjes së dividendës, Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. nuk kanë arritur nivelin e realizimit të fitimit që do të mundësonte ndarjen e dividendës, sipas rregulloreve dhe akteve juridike që e rregullojnë këtë proces. Ky është një aspekt që do të kërkojë përmirësim dhe rritje të performancës financiare në periudhën e ardhshme, për të arritur në përmbushjen e objektivave të planifikuara dhe krijimin e mundësive për shpërndarjen e dividendës në të ardhmen.

II.3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JOEKZEKUTIVË

Në këtë pjesë të raportit, pasqyrohen të dhënat për drejtorët joekzekutivë të angazhuar gjatë vitit 2025, duke përfshirë gjithashtu pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/182, datë 10.01.2024. Në përputhje me këtë vendim dhe në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve ka ushtruar kompetencat e tij në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive që dalin nga ligjet dhe rregulloret e tjera të aplikueshme për ndërmarrjet publike.

Gjatë vitit 2025, përkatësisht nga data 18.11.2025, Bordi i Drejtorëve punën e vet e ka zhvilluar në mungesë të një drejtori, pasi që Ruzhdi Zeqiri ka dhënë dorëheqje, i cili gjithashtu ka qenë edhe Kryesues i Komisionit të Auditimit.

Gjatë vitit 2025, Bordi ka mbajtur gjithsej pesëmbëdhjetë (15) mbledhje, përfshirë këtu edhe Mbledhjen e Kuvendit Vjetor të Aksionarëve. Gjatë këtyre mbledhjeve, janë diskutuar çështje kyçe për zhvillimin e Ndërmarrjes dhe për zgjidhjen e problemeve të ngërthyer nga vitet e kaluara.

Në vijim, pasqyrohen të dhënat e detajuara për strukturën dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025, përfshirë edhe pjesëmarrjen e zyrtarëve tjerë në këto mbledhje.

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve për vitin 2025:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Jetmir Nuka	Kryesues	15
2	Vjollca Salihu	Anëtare	15
3	Luljeta Lutfiu	Anëtare	14
4	Ruzhdi Zeqiri	Anëtar	13
5	Kimete Fazliu	Anëtare	15
6	Afrim Bulluti	Anëtar	15
7	Agron Statovci	Kryeshef Ekzekutiv	15
8	Burim Bylygbashi	ZKFTH	14
9	Afrim Kuleta	Sekretar	14

II.4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE

Për të siguruar përmbushjen e obligimeve ligjore dhe për të arritur një performancë optimale të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve ka krijuar komitete të cilat kanë ndihmuar në menaxhimin e disa prej çështjeve dhe detyrave të tij. Komitetet kanë pasur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e eficiencës dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike të Ndërmarrjes.

Përveç komiteteve të Bordit, gjithashtu edhe Komisioni i Auditimit, i cili është formuar nga Aksionari në bazë të Vendimit Nr. 01/724, të datës 29.01.2024, ka pasur një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve financiare të Ndërmarrjes. Pas dorëheqjes së Kryesuesit të Komisionit të Auditimit, më 26.12.2025 Aksionari ka bërë emërimin e Komisionit të Auditimit.

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur gjithsej dymbëdhjetë (12) mbledhje të Komisionit të Auditimit dhe tetë (8) mbledhje të Komitetit për Hulumtime dhe Teknologji. Çdo komitet ka pasur një përqendrim të veçantë në aspekte të ndryshme të punës së Ndërmarrjes, duke kontribuar në një menaxhim më të strukturuar dhe të koordinuar.

Në vijim, pasqyrohen detajet për përbërjen, funksionimin dhe mbledhjet e mbajtura nga këto komitete gjatë vitit 2025.

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Komisionit të Auditimit për vitin 2025:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje	
KOMISIONI I AUDITIMIT 29.01.2024 – aktiv	1	Ruzhdi Zeqiri	Kryesues	12
	2	Kimete Fazliu	Anëtare	12
	3	Luljeta Lutfiu	Anëtare	12
	4	Armend Shehu	U.D. ZAB	09
	5	Suzanë Mustafa	ZAB	3

	6	Burim Bylygbashi	ZKFTH	12
	7	Afrim Kuleta	Sekretar	12

Të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Komitetit për Hulumtime dhe Teknologji për vitin 2025:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje	
KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 29.08.2024 – 28.08.2025	1	Afrim Bulluti	Kryesues	8
	2	Luljeta Lutfiu	Anëtare	8
	3	Agron Statovci	Anëtar	7
	4	Altin Podrimçaku	Këshilltar	8
	6	Afrim Kuleta	Sekretar	8

Në përfundim të vitit 2025, mund të theksojmë se, pavarësisht sfidave të shumta dhe situatës financiare të vështirë, Ndërmarrja ka arritur të realizojë një sërë objektivash dhe të bëjë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e gjendjes operative dhe financiare.

Angazhimi i Bordit të Drejtorëve, mbështetur nga punët e komiteteve të Bordit dhe angazhimi i stafit menaxhues, ka qenë vendimtar në zbatimin e masave që kontribuuan në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe strategjike. Pavarësisht sfidave të infrastrukturës dhe mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore, kemi vazhduar me hartimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e mëtejshëm të Ndërmarrjes, dhe përpjekjet tona për ristrukturim kanë filluar të japin rezultate, megjithëse nuk janë arritur të gjitha objektivat operative dhe financiare.

Për vitin 2026, përkushtimi jonë do të jetë drejt përmirësimit të performancës financiare dhe operative, me një fokus të veçantë në modernizimin e mjeteve lëvizëse. Angazhimi për gjetjen e burimeve të financimit dhe mundësive të investimeve do të mbetet prioritet, duke u mbështetur në strategjitë e planifikuara dhe kërkesat e zhvillimit të sektorit hekurudhor në Kosovë.

Mbi të gjitha, Bordi i Drejtorëve mbetet i angazhuar për të siguruar një qeverisje të përgjegjshme dhe për të përmbushur obligimet si ndaj Aksionarit ashtu edhe ndaj të gjitha palëve të interesuara. Do të vazhdojmë të punojmë për një të ardhme të qëndrueshme dhe të suksesshme të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.

Në emër të Bordit të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A.

Jetmir NUKA – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh.A. vitin 2025 arriti që ta përmyll me rezultate më të mirë krahasuar me vitin paraprak, por të kënaqshme krahasuar me vitet paraprake, duke marr për bazë ndikimin e shumë faktorëve të ndryshëm si: ndërprerja e plotë e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit nga shkaku i punimeve në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore” si dhe ndërprerja e transportit vendor të mallrave nga klienti ynë NewCo Ferronikeli.

Nga ndikimi i faktorëve që u theksuan më lart, gjatë vitit 2025 Ndërmarrjes i janë shkaktuar probleme të mëdha, sidomos në mosrealizimin e planifikimeve të deklaruara nga ana e bashkëpunëtorëve (klientëve) tanë. Këta faktorë kanë pasur ndikim direkt në (mos) përmbushjen e parashikimeve sipas Planit të Biznesit.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimin e afateve ligjore të raportimit, Ndërmarrja ka arritur që këto obligime t'i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme operuese nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek Aksionari mbi gjendjen dhe zhvillimet në Ndërmarrje.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Vazhdojnë të mbetën sfidë fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Aktualisht transporti hekurudhor ndërkombëtar është plotësisht i ndërprerë, përderisa në linjën ndërkombëtare përmes Maqedonisë së Veriut, transporti është ndërprerë nga punimet që janë duke u zhvilluar në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të Hekurudhore”, transporti ndërkombëtar përmes kufirit në veri qëndron i mbyllur për arsye të njohura politike. Pamundësia e zhvillimit të transportit ndërkombëtar ka ndikuar në performancën e Ndërmarrjes dhe ka ndikuar që shumë klientë potencialë të orientojnë transportin e tyre përmes alternativa tjera.

Për të tejkaluar pengesat e shfaqura dhe për të arritur objektiva, angazhimi ynë do të jetë me fokus të veçantë në investime të vazhdueshme, të cilat do të kenë ndikim në uljen e shpenzimeve, përmirësim koherent të shërbimit dhe në drejtim të zhvillimit të vazhdueshëm të ofertës dhe rritjes së efikasitetit dhe përmirësime të dukshme dhe efikase sipas strukturës së re organizative. Me strukturë e re organizative, në një të ardhme të afërt do të reflekton edhe në zvogëlimin e shpenzimeve në koston e punës.

**Kryeshef Ekzekutiv
Agron STATOVCI**

III.1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Ngjarjet kryesore më rëndësi të veçantë që e kanë shoqëruar Trainkos-in gjatë vitit 2025 janë të paraqitura si në vijim:

1. Ndërmarrja që nga janari i vitit 2025 ka fillua punën me skemë të re organizative, edhe pse zbatimi ka qenë sfidues konsiderojmë se ka rezultate në rritje e përgjegjësi të stafit në përgjithësi. Ky ndryshim ka përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin mes ekipeve, duke e bërë ndërmarrjen më të gatshme për të përballuar sfidat e ardhshme.
2. Gjatë vitit 2025, nuk është realizuar projekti riparimit i mesme për katër vagonë, por jam zhvillua disa projekte investime kapitale që kanë shërbye për mbajtjen në operim të mjeteve tërheqëse dhe tërhequra (vagonët).
3. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë organizuar trajnime të brendshme, si dhe trajnime të organizuara nga Divizioni për Kordinim dhe Ngritje të Kapaciteteve, Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQH/AB), në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe GIZ-in. Këto trajnime janë bazuar në Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (SGAB) dhe kanë synuar zhvillimin e sinergjive ndërmjet palëve, përmirësimin e menaxhimit dhe optimizimin e burimeve, në përputhje me interesat e përbashkëta dhe objektivat strategjike.
4. Po ashtu, janë ndjekur trajnime të organizuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).
5. Pjesëmarrja aktive në punëtoritë të organizuar nga Sekretariati për zbatimin e Traktatit për Transport, përmes ARH-ve, që reflekton në përmirësimin e aktiviteteve të Ndërmarrjes si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhor dhe përshtatjen e reformave të domosdoshme për të qenë pjesë integruese e sistemit Evropian për transportin e udhëtarëve dhe mallrave. Me avancimin e proceseve përfitojnë udhëtarët që shfrytëzojnë transportin me hekurudhë dhe bizneset për transportin e mallrave në dhe nga Republika e Kosovës;

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve për periudhën dymbëdhjetë mujore, nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2025, si dhe do të bëhet krahasimi me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë me planin e Biznesit të vitit 2025 si dhe duke krahasuar me realizimin e vitit paraprak 2024.

IV.1. TRANSPORTI I MALLRAVE

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për vitin 2025 si dhe të dhënat krahasuese me realizimin e vitit të kaluar, si dhe me planifikimin për vitin 2025.

Realizimi në transportin e mallrave 2025

Përshkrimi	Sasia e Transportuar Janar – Dhjetor 2025
Realizimi Neto Ton në 2024	1,984.66 Ton
Realizimi Neto Ton në 2025	0.00 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2025	430,000 Ton
Dallimi: Realizim 2025 – Realizim 2024	-1,984.66Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2025	-430,000Ton
Dallimi: Realizim 2025– Realizim 2024 (%)	0.00%
Dallimi: Realizim 2025 – Planifikim 2025(%)	0.00%

Tabela 4.1.1

Siç mund të shihet nga tabela më lartë, gjatë vitit 2025 nuk kemi transportuar fare transport . Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2025 ka qenë:

Përshkrimi	Numri i Transportuar i Kontejnerëve (Janar – Dhjetor 2025)
Kontejnerë të plotë – 2025	00.00 copë
Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2025	00.00 copë

Tabela 4.1.2

Sasia e transportuar në Neto ton për vitin 2025




Figura 4.1.1

Siç mund të shihet nga figura më lartë ,në aspektin operativ nuk kemi arritur të realizojmë transportin nga planifikimi i Planit të Biznesit për vitin 2025.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Përshkrimi	Të hyrat për periudhën (Janar - Dhjetor 2025)
Realizim shitje të hyra 2024	10,704.61
Realizim shitje të hyra 2025	5,995.79
Planifikimi 2025	1,000.000.00
Realizim 2025 - Realizim 2024	-4,708.82
Realizim – Planifikim 2025	-994,004.21.00
Realizim 2025 - Realizim 2024 (%)	-43.99%
Realizim – Planifikim 2025 (%)	0.60%

Tabela 4.1.3

Siç mund të shihet nga tabela më lartë të hyrat nga transporti i mallrave janë realizuar në shkallë prej 0.60% të planifikimit për vitin 2025

Të hyrat në periudhën vjetore 2025




Figura 4.1.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	0.00€
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	5,995.79 €
Total shitjet	5,995.79€
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	275,109.98 €
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	4,843.40€
Total shpenzimet	273,953.38 €
Fitimi/humbja operative	-273,957.59€
Fitimi/humbja në %	-45.69%

Tabela 4.1.4

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë pjesë 3.55% të shpenzimeve në total të kompanisë, kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me tren/kilometra në komunikacion.

Mallrat e transportuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2025
 Gjatë vitit 2025 nuk kemi pasur transport .




Figura 4.1.2

Revokimi i Trenave

Gjatë vitit 2025 ka pasur revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim bashkë me vlerën e kompensimit sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import –eksport)dhe transport vendor.

Janar - Dhjetor 2025	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	316	0.00	0.00	0.00	0.00 €
Vendor	380	532	0.00	0.00	2,332.82€
Total	696	532	0.00	0.00	0.00 €

Tabela 4.1.5

Në tabelën më lart shihet se gjatë vitit 2025 në import dhe eksport janë revokuar në total 316 trena, Nga këto revokime me kompensim 0% janë 0 trena me 10% janë 0. trena ,me 20% janë 0 trena dhe me revokime 100% janë 0 trena. Revokimet me 0% janë nga shkaku i mbylljes së Linjës së 10 Hekurudhore nga punimet që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e saj, për të cilat revokime nuk ngarkohemi me shpenzime nga Menaxheri i Infrastrukturës.

Po ashtu, në tabela më lartë ,shihet se gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2025 në transportin vendor në total janë 912 trena të revokuar. Nga këto revokime ,me kompensim të shumës prej 10% të qasjes në binarë janë 532 trena, Revokimi i këtyre trenave ka ndodhur për shkak se NewCo Ferronikeli nuk ka transportuar sipas planifikimit

IV.2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Transporti i hekurudhor i udhëtarëve edhe gjatë vitit 2025 ka qenë i kufizuar për shkak të punimeve në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, përkatësisht në Linjën e Hanit të Elezit. Gjatë këtij viti, transporti i udhëtarëve është realizuar vetëm në Linjën Prishtinë – Pejë – Prishtinë me gjashtë trena në ditë, tre në shkuarje dhe tre në ardhje.

Gjatë vitit 2025 numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar ka qenë 88,036, ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave ID kartelave dhe udhëtimeve të organizuara ka qenë 78,938.78

Krahasuar me vitin 2024, numri i udhëtarëve në vitin 2025 është për +19,293 më i lartë, apo shprehur në përqindje është për +28.07 % më shumë, ndërsa krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për -964 më i ulët, apo shprehur në përqindje -1.08 %. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për

+19,542.78 € më i lartë apo +32.90 %, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për +8,938.78 € më të larta, apo +12.77 %.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore të dhënat për performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për vitin 2025 si dhe të dhënat krahasuese me ato të vitit 2024 si dhe me planifikimin për vitin 2025.

Performanca operative në transportin e udhëtarëve në vitin 2025:

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2024	68,743
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2025	88,036
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2025	89,000
Dallimi: Realizim 2024 - 2025	+19,293
Dallimi: Realizim - planifikim 2025	-964
Dallimi: Realizim(2024 – 2025) në %	+28.07
Dallimi: Realizim – planifikim 2025	-1.08

Tabela 4.2.1

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, numri i udhëtarëve të transportuar gjatë vitit 2025 ka qenë më i lartë për 28.07 % në krahasim me vitin 2024 ndërsa krahasuar me planifikimin realizimi ka qenë për -1.08 % më i ulët.

Sqarim: Në numrin e përgjithshëm të udhëtarëve të transportuar nuk janë të përfshirë udhëtarët që janë të liruar nga pagesat e udhëtimit, ende nuk është krijuar ndonjë mekanizëm për evidentimin e tyre.

Performanca financiare në transportin e udhëtarëve në vitin 2024:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2024	59,396.71
Realizim shitje të hyra 2025	78,938.78
Planifikimi 2025	70,000
Dallimi: Realizim 2024 - realizim 2025	+19,542.78
Dallimi: Realizim - planifikim 2025	+8,938.78
Dallimi: Realizim 2024 - realizim 2025 në %	+32.90
Dallimi: Realizim - planifikim 2025 në %	+12.77

Tabela 4.2.2

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, realizimi financiar nga transporti i udhëtarëve gjatë vitit 2025 ka qenë më i lartë për +32.90% në krahasim me vitin 2024, ndërsa krahasuar me planifikimin realizimi ka qenë për +12.77 % më i lartë.




Figura 4.2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve:

Përshkrimi - Të hyrat	
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve – OSHP - MMPHI	1,062,229.75 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - ME	610,000.00 €
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	78,938.78€
Total të hyrat	1,751,168.53 €
Shpenzimet direkte në TU	764,804.80 €
Shpenzimet indirekte në TU	1,285,689.3 €
Total shpenzimet	2,050,494.1 €
Fitimi / humbja operative	-299,352.57€

Tabela 4.2.3




Figura 4.2.4

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej -0,17% gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP-MMPHI, ME si dhe të hyrat nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje: Shpenzimet indirekte janë përlllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 98.82% nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.

IV.3. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE - MML

Në kuadër të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore përfshihen mirëmbajtja e trenave motorikë, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

Realizmi i punimeve të kryera në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse gjatë vitit 2025 është pasqyruar përmes tabelave si në vijim të këtij raporti si dhe janë bërë edhe krahasimet me realizimin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak:

IV.3.1 Mirëmbajtja e trenave motorikë

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorikë të realizuara në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2025	2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0

2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 4.3.1

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart, gjatë vitit 2025 nuk ka pasur servisimeve të trenave motorikë për shkak se gjatë këtij viti ata nuk kanë qenë në operim.

IV.3.2 Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2025	2024	Ndryshimi
1.	Servisime	349	390	-41
2.	Riparime	40	51	-11
3.	Kontrollime K1	26	27	-1
4.	Kontrollime K3	7	6	1
5.	Kontrollime K6	7	9	-2
6.	Gdhendje te rrotave	1	3	-2

Tabela 4.3.2

IV.3.3 Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2025	2024	Ndryshimi
1.	Servisime	1	2	-1
2.	Riparime	6	9	-3
3.	Kontrollime K1	8	2	+6
4.	Kontrollime K3	2	1	+1
5.	Kontrollime K6	1	1	0

Tabela 4.3.3.1

Intervenimet për secilin mjet tërheqës gjatë vitit 2025:

Mjeti tërheqës	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime	164	3	11	3	0	168	1		
Riparime	9	5	4	3	1	18	6		
Kontrollime mujore K1	6	7	8	0	0	6	8		
Kontrollime tremujore K3	2	2	2	0	0	1	2		
Kontrollime gjashtëmujore K6	2	1	2	1	0	1	1		

Gdhendje të rrotave	1	0	0	0	0	0	0		
----------------------------	---	---	---	---	---	---	---	--	--

Tabela 4.3.3.2

S - Servisim,
R - Riparim,
K1 - Kontrollime njëmuajor,
K3 - Kontrollime tremujor,
K6 - Kontrollime gjashtëmuajor

IV.3.4 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve të realizuar në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2025	2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime K1	37	52	-15
2.	Riparim në punëtori	52	70	-18
3.	Gdhendje të rrotave	3	11	-8
4.	Riparim në stacion	1	1	0

Tabela 4.3.4

IV.3.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuara në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2025	2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

Tabela 4.3.5

IV.3.6 Riparimi i vagonëve të huaj

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	2025	2024
NewCo Ferronikeli	0.00 €	0.00 €

Tabela 4.3.6

V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare Janar – Dhjetor 2025
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2025)
3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2025)
4. Bilanci i Gjendjes (Janar – Dhjetor 2025)

V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2025, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

V.1.1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat në shumë prej 1,985.00€ për periudhën Janar-Dhjetor 2025 nga dy projekte te organizatave te artit dhe kulturës. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2025 është 1,000,000.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 0.20% nga totali.

Transporti i udhëtarëve gjatë vitit 2025 është realizuar në shumën prej 1,751,168.54€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,062,229.75€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencionin për mbulimin e pjeshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 610,000.00€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 78,938.79€. Shprehur në përqindje realizimi i të hyrave nga transporti i udhëtarëve është arritur në shkallën prej 88.43%, krahasuar me planifikimet e vitit 2025 – 1,980,275.00€.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë vitit 2025, kanë arritur shumën prej 4,010.79€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2025, e cila është 30,000.00€ arrin kuotën prej 13.37% të realizimit. Kjo e hyrë është realizuar nga kontrata me kompaninë GCF dhe shërbime tjera gjatë vitit 2025.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, kanë arritur shumën prej 45,399.52€. Këto të hyra janë realizuar nga pozicionet si në vijim: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A. – 21,096.10€, të hyrat nga qiraja në 17,796.61€, të hyrat nga kompenzim dëmit në shumën prej 1,380.00€, të hyra nga skrapin 2,109.60€, të hyra nga llogaria e kursimeve FLEX në shumën prej 1,513.95 dhe të hyra nga lejimi financiar në shumën prej 1,503.26€ . Buxheti i planifikuar për këto të hyra ka qenë 86,000.00€, shprehur në përqindjen është realizuar 52.79% e planifikimit.

Të hyrat e realizuara gjatë kësaj periudhe nuk janë të kënaqshme, arsyeja e mos realizimit të planifikuar është si pasojë e rregullimit të Linjës së Dhjetë Hekurudhore nga HK-Infrakos Sh.A., e cila ka ndikuar negativisht në realizimit e të hyrave për Transikos Sh.A.

V.1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën Janar–Dhjetor 2025, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara si në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për viti 2025 është 500,496.50€, ndërsa planifikimi ka qenë në shumën prej 1,221,500.00€, i cili është realizuar në shkallën prej 40.97%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

Shpenzimet e stafit janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,237,104.11€, dhe atë në paga dhe kontribute 1,236,384.11€, trajnime dhe shpenzime tjera në vlerë prej 720.00€. Në total, nëse krahasojmë shumën e buxhetuar prej 1,450,000.00€ për vitin 2025, kuota e realizimit është arritur në shkallën prej 85.32%.

Totali i shpenzimeve operative arrin shumën prej 49,467.46€, kjo shumë është vetëm 47.43% nga shuma prej 104,300.00€ e parashikuar në vitin 2025. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2025.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 22.42%, konkretisht në shumën prej 26,046.76€. Planifikimi për vitin 2025, i kësaj kategorie është 116,200.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

V.1.3. Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Dhjetor 2025


	EMËRTIMI	Planifikimi Janar - Dhjetor 2025	Realizimi Janar - Dhjetor 2025	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar - Dhjetor 2024
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	1,000,000.00	1,985.00	998,015.00	0.20	10,704.61
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	1,300,000.00	1,062,229.75	237,770.25	81.71	1,000,787.51
3	TU – Ministria e Ekonomisë	610,275.00	610,000.00	275.00	99.95	610,725.00
4	TU – Shitja e Biletave	70,000.00	78,938.79	(8,938.79)	112.77	59,396.71
5	Shërbimet tjera	30,000.00	4,010.79	25,989.21	13.37	6,000.00
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	20,000.00	-	20,000.00	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	86,000.00	45,399.52	40,600.48	52.79	57,516.43
I	TOTAL – TË HYRAT	3,116,275.00	1,802,563.85	1,313,711.15	57.84	1,745,130.26
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	774,000.00	263,704.42	510,295.58	34.07	316,541.40
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	21,500.00	17,997.81	3,502.19	83.71	20,716.37
3	Inventar dhe pajisje	5,000.00	-	5,000.00	-	696.53
4	Material harxhues	1,000.00	-	1,000.00	-	-
5	Pjesë	60,000.00	20,698.42	39,301.58	34.50	32,654.66

	rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera					
6	Qasja në binarë	320,000.00	168,776.92	151,223.08	52.74	174,251.73
7	Sigurimi i palëve të treta	5,000.00	1,680.00	3,320.00	33.60	1,692.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	10,000.00	6,317.94	3,682.06	63.18	-
9	KMSH Nafta Infrakos	20,000.00	21,320.99	(1,320.99)	106.60	25,388.98
10	Servisimi i arkave fiskale	5,000.00	-	5,000.00	-	3,661.00
11	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	1,221,500.00	500,496.50	721,003.50	40.97	575,602.67
	Fitimimi (humbja) bruto	1,894,775.00	1,302,067.35	592,707.65	68.72	1,169,527.59
	TË ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	-	-	-	-	
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	-	-	-	-	6,266.94
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	
4	Të ardhura tjera (shitja e skrapit-mbeturinat)	-	-	-	-	
	TOTAL – Të ardhurat tjera	-	-	-	#DIV/0!	6,266.94
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,445,000.00	1,236,384.11	208,615.89	85.56	1,386,144.18
2	Trajnime dhe shpenzime tjera	5,000.00	720.00	4,280.00	14.40	873.50
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,450,000.00	1,237,104.11	212,895.89	85.32	1,387,017.68
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	5,000.00	969.49	4,030.51	19.39	5,600.15
2	Shpenzimet logjistike	10,000.00	8,586.10	1,413.90	85.86	20,480.40
3	Energjia elektrike dhe komunali	7,000.00	13,264.41	(6,264.41)	189.49	173.56
4	Kontrollimet sistematike	3,000.00	1,950.00	1,050.00	65.00	2,350.00
5	Marketingu	9,000.00	1,276.00	7,724.00	14.18	926.80
6	Udhëtimet zyrtare	3,000.00	-	3,000.00	-	535.83
7	Telefonat dhe Posta	9,500.00	7,882.01	1,617.99	82.97	8,761.04
8	Shërbimet bankare	1,000.00	735.11	264.89	73.51	638.62
9	Tatimet	42,000.00	7,789.04	34,210.96	18.55	64,097.48
10	Pajisje elektronike	14,800.00	7,015.30	7,784.70	47.40	1,580.44
	TOTAL - Shpenzimet operative	104,300.00	49,467.46	54,832.54	47.43	105,144.32

E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	10,000.00	99.00	9,901.00	0.99	54.41
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	28,000.00	5,814.68	22,185.32	20.77	5,814.68
3	Material i zyrës	17,500.00	4,871.05	12,628.95	27.83	7,188.64
4	Material sanitar	7,000.00	1,007.16	5,992.84	14.39	1,443.65
5	Qiraja për objektet	15,000.00	7,760.44	7,239.56	51.74	7,388.54
6	Reprezentacioni dhe bufeja	4,000.00	1,320.18	2,679.82	33.00	2,906.07
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	4,700.00	72.00	4,628.00	1.53	90,481.62
8	Shpenzimet logjistike	20,000.00	4,766.27	15,233.73	23.83	3,537.71
9	Kontigjente	10,000.00	335.98	9,664.02	3.36	-
	TOTAL - Shpenzimet administrative	116,200.00	26,046.76	90,153.24	22.42	118,815.32
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
II	TOTAL - SHPENZIMET (B+C+D+E)	2,892,000.00	1,813,114.83	1,078,885.17	62.69	2,186,579.99
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	224,275.00	(10,550.98)	234,825.98	(4.70)	(435,182.79)
	GRANTET	410,000.00	460,017.26	(49,432.85)	112.06	309,976.14
F	Shpenzimet e zhvlerësimit		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	290,000.00	460,017.26	(169,432.85)	158.43	309,976.14
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	120,000.00	53,056.41	66,943.59	44.21	53,447.03
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	410,000.00	513,073.67	(102,489.26)	125.00	363,423.17
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	104,275.00	(63,607.39)	167,882.39	(61.00)	(488,629.82)


Tabela 5.1.

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2025



Diagrami 5.2

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2025



Diagrami 5.3

V. 2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2025)

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31.12.2025
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	198.06
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	15.58
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	5.20
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	1.62
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	27.52
7	PCB nr. 1114-004229-0001-65	301,304.94
	TOTALI	301,525.40

Tabela 5.4

V.3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2025)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e Ndërmarrjes në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	1,172.54
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	1,843,325.39
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	1,844,299.87
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	198.06

Tabela 5.5

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	0.86
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	281,656.27
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	281,656.27
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	0.86

Tabela 5.6

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	4.38
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	2,033,875.14
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	2,033,872.70
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	6.82

Tabela 5.7

Transaksionet e kompanisë Llogaria e kursimeve FLEX në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	526,109.79
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	1,647,272.00
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Dhjetor 2025	1,872,076.85
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	301,304.94

Tabela 5.8

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar-Dhjetor 2025			Pagesat Janar-Dhjetor 2025		
1	Deponime nga MMPHI	1,172,735.14	1	Pagat e punëtorëve	1,055,593.38
2	Deponime nga Ministria e Ekonomisë	610,000.00	2	Pagesa e derivateve	343,074.09
3	Deponime për Investime Kapitale	281,656.27	3	Pagesë për ATK	191,317.93
4	Deponime nga transporti i udhëtarëve	80,020.00	4	Pagesë për Infracos Sh.A	146,563.75
			5	Pagesë për Investime kapitale	281,656.27
			6	Pagesë për Kontribute 2020,2021.2022	206,517.91
TOTALI		2,144,411.41	TOTALI		2,224,723.33

Tabela 5.9

V.4. Bilanci i gjendjes (Janar – Dhjetor 2025)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	GJENDJA FILLESTARE 01.01.2025	GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2025
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	2,242,734.25	1,892,514.82
Mjetet Qarkulluese	1,012,659.08	834,855.90
Stoqet	420,534.77	465,025.71
Paraja	528,003.53	301,552.92
Llogarite e arketueshme	51,179.71	48,674.84
Kerkesa tjera te arketushme	3,026.72	4,254.63
Parapagimet	9,914.35	15,347.80
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	3,255,393.33	2,727,370.72
Detyrimet afatshkurta	2,117,841.31	1,832,882.32
Llogarite e pagueshme	754,837.32	666,778.27
Te pagueshme tjera - detyrime	558.44	479.91
Detyrime tatimore	997,482.55	791,074.58
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	1,554,696.31	1,376,335.32
Kapitali	5,294,036.25	5,292,941.06
Fitimi/Humbja e bartur	-5,222,550.72	-5,711,180.58
Fitim/ Humbja e vitit	-488,629.86	-63,607.39
Total detyrimet dhe kapitali	3,255,393.32	2,727,370.72

Tabela 5.10

VI. PROJEKTET KAPITALE DHE PROKURIMI

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha projektet/kontratat për vitin 2025, të financuara nga Buxheti Operativ i Trainkos Sh.A., dhe Buxheti i Kosovës.

Nr	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat.	Koment	Periodha Tre (3) mujore
1	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting	10,800.00	10,800.00	Në implementim	TM1 2024
2	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	9,500.00	7,839.97	Në implementim	TM1 2023
3	Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor te tipit 8-710G3B-2	12,000.00	9,971.00	Anuluar	TM2
4	Furnizimi me pajisje dhe pjese rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)	16,000.00	15,147.36	Përfunduar	TM1
5	Furnizimi me pajisje dhe pjese rezerve për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë te udhëtareve)	14,000.00	13,196.47	Përfunduar	TM1
6	Furnizimi me modul për lokomotivën G1700	6,500.00	6,485.28	Përfunduar	TM1
7	Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645	7,500.00	4,472.20	Përfunduar	TM1
8	Furnizimi me laptop për nevoja te Bordit	2,400.00	1,090.00	Përfunduar	TM1

	te Drejtoreve te Trainkos Sha				
9	Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)	6,500.00	6,431.00	Përfunduar	TM2
10	Furnizimi me material Higjienik	50000	1,482.73	Në procedurë	TM1
11	Furnizimi me brusha për lokomotivën 645	3,800.00	2,478.00	Përfunduar	TM1
12	Furnizimi me materiale administrative	3,300.00	2,444.02	Kontraktuar	TM1
13	Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha	1,400.00	1,299.01	Kontraktuar	TM1
14	Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve	365,420.00	-	Anuluar	TM2
15	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016	100,000.00	97,309.51	Kontraktuar	TM2
16	Rregullimi i Automjetit Hyundai X35	850.00	916.00	Kontraktuar	TM2
17	Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve	500.00	-	Anuluar	TM2
18	Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2	7,000.00	6,159.60	Përfunduar	TM2
19	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	2,000.00	1,982.40	Kontraktuar	TM2
20	Furnizim me klime 18 she	650.00	650	Kontraktuar	TM2

21	Furnizimi me printer skaner 4in1	260.00	260	Kontraktuar	TM2
22	Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L	990.00	900	Kontraktuar	TM3
23	Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve	870.00	844	Kontraktuar	TM3
24	Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025	500.00	-	Anuluar	TM2
25	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML. Furnizimi me çelësa specialë për demontimin dhe montimin e kokave të lokomotivave të tipit 661 dhe 645.	6,500.00	6,018.00	Kontraktuar	TM3
26	Mirëmbajtja e Infrastrukturës kryesore të IT-së	24,000.00	23,998.36	Kontraktuar	TM3
27	Furnizimi dhe Riparimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML, Lot1 Furnizimi me siguresa stratuere per lokomotiva 400Am x25 V. Lot 2, Furnizimi me kontktor te kyeqjes	3,800.00	-	Anuluar	TM3
28	Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025	500.00	500.00	Kontraktuar	TM3
29	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645	100,000.00		Në OSHP	TM4

	2620-005				
30	Furnizimi dhe instalimi i gjeneratorit statik me kapacitet 150 kW	17,000.00	11,870.80	Përfunduar	TM4
31	Investim ne asete Kapitale-Transport specifik i 5 vagonëve të udhëtarëve (me makineri të rëndë)	64,036.00	-	Pezulluar	TM4
32	Furnizimi me bateri startuese plumbi për lokomotiva.	30,000.00	19,993.92	Kontraktuar	TM4
33	Furnizimi me bateri për vagonë të transportit të udhëtarëve	26,000.00	16,595.52	Kontraktuar	TM4
34	Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë	24,000.00	27,144.13	Kontraktuar	TM4
35	Shërbimet e abonimit te arkave fiskale	4,500.00	4,319.98	Kontraktuar	TM4
36	Furnizim me rregullator ngacmimi statik për gjeneratorin KATO në lokomotivën 645	9,000.00	8,979.80	Kontraktuar	TM4
37	Furnizim me 5 sete komplet të diktunave për frenues indirekt Westinghouse 26C	4,000.00	-	Publikuar	TM4
38	Shërbimet e shtypjes se orarit te lëvizjes se trenave (OLT)	300.00	194.70	Në Implementim	TM4
39	Furnizimi me materiale promovuese për fundvit	990.00	837.80	Në Implementim	TM4
40	Riparim i frenuesve indirekt	7,000.00	-	Publikuar	TM4

- 1. Shërbimet e mirëmbajtjes se sistemit financiar PLANET Accounting** - është nënshkruar kontrata më datën 10.01.2024 dhe është projekt për 3 vite, është procedurë e negociuar pa publikim.
- 2. Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025** - Projekti është kontraktuar për periudhë tre vjeçare dhe është në zbatim e sipër. Operatori Ekonomik ka përfunduar pjesën e dytë të kontratës për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2024 dhe e njëjta është faturuar.
- 3. Furnizimi me modul kontrollë për diesel motor te tipit 8-710G3B-2, O.E** është tërhequr nga kontrata dhe jemi detyruar për të shkuar në anulim.
- 4. Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)**- Projekti ka përfunduar.
- 5. Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtarëve)**- projekti ka përfunduar dhe është pranuar fatura dhe është dërguar për pagesë.
- 6. Furnizimi me modul për lokomotivën G17000**, projekti ka përfunduar.
- 7. Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645** – është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
- 8. Furnizimi me laptop për nevoja të Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sha** – është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
- 9. Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)**- ka ardhur fatura e njëjta është dërguar për procesim të pagesës.
- 10. Furnizimi me material Higjienik** - është shpallur oferta fituese me të cilën është nënshkruar kontrata me O.E. PM GROUP SH.P.K. me çmim 1,482.73 €.
- 11. Furnizimi me brusha për lokomotivën 645** – është bërë hapja e tenderit kemi pranuar 8 oferta, komisioni i vlerësimit ka marr ofertat për vlerësim. Eshte nënshkruar kontrate me O.E. GETNO L.L.C. ne vlerë 2,478.00 €, projekti ka përfunduar pasi është bërë liferimi i mallit sipas afateve, është shkruar për pagesë.
- 12. Furnizimi me materiale administrative** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlere prej 2,444.02 €.
- 13. Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlere 1,299.01 €.
- 14. Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve** - është bërë anulimi i tenderit.
- 15. Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016** – Projekti ka përfudnuar.
- 16. Rregullimi i Automjetit Hyundai X35** - është bërë hapja e tenderit dhe kemi pranuar një oferte nga NTP Auto Bosch me çmim prej 916.00 €. Projekti ka përfunduar.
- 17. Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve** – ky projekt është tenderuar dy herë dhe nuk kemi pranuar asnjë ofertë.
- 18. Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2** - projekti është pranuar nga komisioni i pranimit teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.

19. **Shërbimet e sigurimit të palëve të treta**, është nënshkruar kontrata me O.E.
20. **Furnizim me klime 18-she-** kemi pranuar një ofertë dhe e njëjta është shpallur fituese.
21. **Furnizimi me printer skaner 4ne1** - projekti ka përfunduar, fatura është dërguar për pagesë.
22. **Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L** – kemi pranuar një oferta nga Ujë Rogove Sh.P.K., dhe e kemi shpallur fitues, çmimi për bidon është 1.5 €.
23. **Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve** – kemi pranuar dy ofertues, dhe kemi shpallur fitues ofertuesin UBT me çmim 844.00 €.
24. **Shërbimet e mirëmbajtjes së domenit dhe hostit për vitin 2025** – nuk kemi pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.
25. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML. Furnizimi me çelësa special për demontimin dhe montimin e kokave të lokomotivave të tipit 661 dhe 645.**, projekt menaxheri na ka njoftuar se pajisja ka ardhur, jemi në pritje të raportit të pranimit teknik.
26. **Mirëmbajtja e infrastrukturës kryesore të IT-së**, është nënshkruar kontrata me O.E dhe projekti është në implementim.
27. **Furnizimi dhe Riparimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML, Lot1 Furnizimi me siguresa stresuese për lokomotiva 400Am x25 V. Lot 2, Furnizimi me kontaktor te kyeqjes**, nuk kemi pranuar asnjë ofertë dhe kemi shkuar në anulim.
28. **Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025**, projekti ka përfunduar.
29. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005**, lënda është në OSHP.
30. **Furnizimi dhe instalimi i gjeneratorit statik me kapacitet 150 kW**, projekti ka përfunduar.
31. **Investim ne asete Kapitale-Transport specifik i 5 vagonëve të udhëtarëve (me makineri të rëndë)**, kemi bërë njoftimin për kontratë më datën 17.09.2025, hapja e tenderit është bërë më datën 03.10.2025 dhe kemi pranuar një ofertë në vlerën prej 99,769.00 €, e cila është anuluar për shkak të tejkalimit substancial 55% mbi vlerën e parashikuar, e njëjta është ritenderuar më datën 06.10.2025 dhe do të bëhet hapja e tenderit më datën 24.10.2025. Kemi pranuar dy oferta dhe oferta me çmimin më të lirë është eliminuar edhe të dytën jemi detyruar ta eliminojmë për arsye të tejkalimit të buxhetit të planifikuar prej 40.15 %.
32. **Furnizimi me bateri startuese plumbi për lokomotiva.**, është nënshkruar kontrata me O.E EL PROJEKT SH.P.K., me çmimin prej 19,993.92 eurosh.
33. **Furnizimi me bateri për vagonë të transportit të udhëtarëve**, është nënshkruar kontrata me O.E., Profitech SH.P.K., ME çmimin prej 16,595.52 eurosh.
34. **Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë**, është nënshkruar kontrata me O.E SANKOS SH.P.K.N me çmim prej 27,144.13 eurosh..
35. **Shërbimet e abonimit te arkave fiskale**, është nënshkruar kontrata me O.E ENTERNET SH.P.K., me çmim prej 4,319.98 eurosh.
36. **Furnizim me rregullator ngacmimi statik për gjeneratorin KATO në lokomotivën 645**, është nënshkruar kontrata me O.E DIARI BM SH.P.K, me çmim prej 8,979.80 eurosh.

37. **Furnizim me 5 sete komplet të diktunave për frenues indirekt Westinghouse 26C**, kemi pranuar një ofertë nga O.E N&B SH.P.K, në vlerë prej 3,822.00 eurosh.
38. **Shërbimet e shtypjes se orarit te lëvizjes se trenave (OLT)**, kemi pranuar dy oferta nga dy OE: TROTEK SH.P.K., në vlerë prej 243.00 € dhe MEDIMATECH & PRINT SH.P.K., në vlerë prej 194.70 €.
39. **Furnizimi me materiale promovuese për fundvit**, kemi pranuar dy oferta nga dy OE: TROTEK SH.P.K., në vlerë prej 875.00 € dhe MEDIMATECH & PRINT SH.P.K., në vlerë prej 837.80 €.
40. **Riparim i frenuesve indirekt Westinghouse 26C për lokomotivat GM G16 (661)**, hapja e tenderit do të bëhet më datën 09.01.2026.

Ndërsa sa i përket financimit të projekteve kapitale nga buxheti i Kosovës për vitin 2025 kanë qenë në dispozicion 489,275.00 € dhe janë shfrytëzuar 282,096.93 € apo 57.65% e mjeteve dhe mjetet e kthyera në buxhet të Kosovës janë: 207,178.07 € apo 42.35% mjeteve.

VII. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

VII.1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Gjatë vitit 2025, TRAINKOS është përballur me mosrealizimin e të hyrave nga transporti i mallrave, sidomos për shkak të ngecjeve në operacionet e New Co Ferronikeli dhe problemeve të saja të brendshme, e cila nuk ka filluar transportin vendor siç ishte planifikuar sipas deklaramit zyrtarë fillestarë. Vonesat në modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore kanë ndikuar negativisht në transportin hekurudhor ndërkombëtar, përkundër disa kërkesave, transport hekurudhor ndërkombëtar nuk ka mund të realizohet. duke çuar klientët në përdorimin e alternativave si autostradat dhe transporti rrugor.

Transporti i pasagjerëve karakterizohet me vazhdimin e zbatimit të Marrëveshjes bazë për OShP 2023 – 2027. Vonesat në projektin e modernizimit të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit kanë kufizuar operacionet e pasagjerëve në vetëm katër trena në linjën Prishtinë – Pejë.

Ndërmarrja duhet të koordinojë planet strategjike shtetërore dhe të sigurojë burime financiare për të realizuar objektivat e saj. Finalizimi i legjislacionit për transportin hekurudhor dhe zbatimi i praktikave më të mira mbeten prioritetet për përafrimin me standardet e BE-së dhe krijimin e një zone të vetme evropiane të transportit hekurudhor.

Modernizimi dhe lëshimi në shfrytëzim i linjave hekurudhore dhe ndërmarrja e masave shtetërore për bartjen e potencialit transportues nga rruga në hekurudhë duhet të mbetet imperativ për zbatimin e praktikave më të mira si dhe finalizimi dhe zbatimi i legjislacionit adekuat për transportin hekurudhorë në Republikën e Kosovës.

Ndërmarrja vazhdon të përballlet me mungesën e flotës së mjeteve lëvizëse për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, pa një përgjigje të qartë mbi pasurimin e flotës. Flota aktuale është e pamjaftueshme për nevojat ekzistuese dhe të ardhshme, ndërsa mungesa e stafit teknik të trajnuar përbën një sfidë shtesë.

Për të garantuar zhvillimin dhe sigurinë në transportin hekurudhor, nevojitet investim në modernizimin dhe mirëmbajtjen e flotës, si dhe anëtarësimi në asociacione ndërkombëtare. Pa këto masa ndërmarrja mbetet e kufizuar në konkurrencën rajonale dhe integrimin në rrjetin evropian të transportit.

Për më tepër, mungesa e mjeteve lëvizëse adekuate dhe buxheti i pamjaftueshëm kanë penguar zhvillimin e shërbimeve të transportit hekurudhor. Strategjia e Transportit Multimodal 2023 – 2030 kërkon modernizimin e flotës dhe përshtatjen me standardet evropiane (ERTMS), por deri më tani, asnjë progres i prekshëm nuk është bërë në këtë drejtim.

Në periudhën raportuese, ndërmarrja ka shqyrtuar mundësi bashkëpunimi ndërkombëtar me institucione të ndryshme por sfidat institucionale dhe mungesa e mbështetjes financiare kanë frenuar avancimin e projekteve.

Ndër prioritetet mbeten:

Përfundimi i projektit të modernizimit të Linjës së 10-të Hekurudhore Leshak - Han i Elezit

Investimi në floten e mjeteve lëvizëse,

Mbështetja institucionale për zhvillimin e transportit hekurudhor si pjesë e Planit Zhvillimor Kombëtar 2023 – 2030,

Përfshirja e Trainkos në planet investive të qeverisë për të siguruar qëndrueshmërinë dhe rritjen e kapaciteteve transportuese.

Në mungesë të zgjidhjeve konkrete, ndërmarrja përballlet me sfida të rënda që rrezikojnë operimin dhe mbijetesën në tregun e transportit.

Pjesëmarrja e TRAINKOS-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhorë përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur takime por edhe është mbajtur kongresi për Lëvizjen Digjitale dhe SIT të organizuar nga Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport në Sevilla (Spanjë) mbështetur nga DG MOVE. Sipas rëndësisë edhe janë bërë përgatitjet e nevojshme, kjo sipas agjendës dhe mundësisë për pjesëmarrje aktive dhe përfitim nga kjo mundësi. Është bërë koordinimi i nevojshëm me pjesëmarrësit tjerë nga MMPHI-ja të cilët janë bartës të politikave të SIT dhe pjesë e transportit tjetër tokësorë në realizimin e konceptit të Transportit Multi Modal. Rrugëtimi dhe mbajtja e takimeve sipas agjendës kanë qenë nga datat 19.05-22.05.2025 në Sevilla. Fillimisht është mbajtur kongresi për Lëvizjen Digjitale dhe SIT (20.05.2025) me përfaqësues së fushës dhe ekspert që prezantonin eksperiencën që mund të ju hyjnë në shërbim shteteve të WB6. Përvojat mundësojnë trasimin e rrugës që këto shtet duhet të e kalojnë për të arritur objektivat e parashtruara nga BE, sipas fazave dhe datat e përcaktuara qartë nga Komisionet përkatëse të përcaktuara nga BE. Po ashtu është mbajtur edhe punëtorja për digjitalizimin e transportit të mallrave dhe udhëtarëve me datën 21.05.2025 që korrespondon me veprimet që shtetet duhet të ndërmarrin në avancimin e SIT. Republika e Kosovës ka prezantuar veprimet pozitive të ndodhura me përgatitjen dhe aprovimin e

Strategjisë SIT dhe Planit të veprimit për zbatimin e sajë. Në takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e MMPHI-së të cilët janë bartës të politikave të SIT dhe pjesë kyçe për digjitalizimin e transportit në përgjithësi, duke e përfshi edhe Ministrin e MMPHI-së. Ministri ka kërkuar mobilizimin e secilit nga entiteti që përfaqësojnë në plotësimin e obligimeve që dalin në këtë fushë, me detyrime konkrete që janë precizuar nga takimet por edhe kërkesat nga DG MOVE për shtetet e Ballkanit Perëndimorë (WB 6). Transporti MultiModal dhe pjesa e politikave tjera shtetërore për TRAINKOS-in janë mundësi për zhvillimin biznesit të TRAINKOS-it për atë edhe pse ekziston dhe është e licencuar.

VII.2. Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante

Edhe në periudhën raportuese për vitin 2025 kanë vazhduar angazhimet në plotësimin e obligimeve ligjore në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë vitit 2025 vlen të veçohen:

- Është bërë analiza e domosdoshme në trasimin e procedurave dhe obligimeve që Trainkos duhet të i përcjellë për futjen në funksion të pesë vagonëve të udhëtarëve pas finalizimit të procesit riparimi i mesëm. Pasi që të njëjtit aktualisht janë në Han të Elezit, obligim i radhës i TRAINKOS-it është që zyrtarisht të njoftoj ARH-në në kohën e futjes në qarkullim. Natyrisht kjo kur të dihet pasi që situata e krijuar me mbylljen e Linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit ende nuk e ka mundësuar këtë;
- Proceset e inspektimit të mjeteve lëvizëse në posedim të Trainkos-it nga ARH janë finalizuar dhe përcjellë zyrtarisht tek Trainkos-i sipas datave të përcaktuara nga ARH;
- Me kërkesën e zyrtarëve të ESK-së janë plotësuar tabela të Anketës për Statistikat e Investimeve që i përkasin Ndërmarrjes sonë;
- Për nevojat e Ndërmarrjes INFRAKOS sipas kërkesës që rrjedh nga obligimet ligjore është përgatitur, plotësuar dhe dërguar pyetësori për kënaqëshmërinë e klientëve. Në këtë rast si klientë për shërbimet si operatorë dhe shfrytëzues i Terminalit;
- Është punuar, kontrolluar dhe dërguar tek ESK formati i plotësuar në tabela që përmbajnë Anketën për Statistikat e Investimeve të ndodhura në vitin 2024;
- Sipas kërkesës dhe nevojës për të i konfirmuar statistikat për transport me hekurudhë për vitet 2022, 2023 dhe 2024 që do të përfshihen në të dhënat që dërgohen në EUROSTAT janë punuar, konfirmuar dhe dërguar tek përgjegjësit në ESK;
- Angazhim përmes përfaqësimit dhe konsultave të brendshme për hartimin e Ligjit të Ri për hekurudhat dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri;
- Është punuar me ARH-në dhe ka përfunduar procedurat e rregullta në shqyrtimin e kërkesë sonë për Ri licencimin e 6 makinistëve dhe konfirmimin e mos licencimit të makinistëve që nuk llogarisim në vazhdimin e punës si makinist në Ndërmarrje. Kjo

në bazë të listës së makinistëve më 19.03.2015 që ju ka skaduar licenca e vlefshme për 10 vjet;

- Për nevojat e raportimeve dhe evidencave nga ARH është kërkuar konfirmimi i transportit të realizuar nga TRAINKOS për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Të njëjtat janë analizuar, ri konfirmuar dhe dërguar me kohë sipas kërkesës;
- Janë kompletuar të dhënat (statistikat në baza mujore) sipas kërkesës së ASK dhe obligimeve ligjore për statistikat e transporti të udhëtarëve dhe mallrave në baza mujore;
- Në bazë të kërkesës rutinore vjetore kemi pranuar kërkesën nga ARH për rishikimin e listës së Marrëveshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të ndodhura brenda vitit. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shqyrtimit të listës është kompletuar përgjigja dhe kthyer tek përgjegjësit e ARH-së;
- Departamenti i Sigurisë pranë ARH-së ka njoftuar për fillimin e përgatitjes së Draft Rregullores për vendosjen e masave praktike për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore. Nga kjo si palë e interesit kanë kërkuar nga TRAINKOS-i që ta caktohet një anëtar për grup punues;
- Me kërkesën e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) që është duke zhvilluar Anketën e Investimeve në Ndërmarrje Publike për vitin 2024 në tërë territorin e Kosovës është punuar në plotësimin e pyetësorit sipas përzgjedhjes së tyre. Anketa bazohet në Ligjin mbi Statistikat Zyrtare - Ligji Nr. 04/L-36, sipas të cilit jemi të detyruar të plotësojmë informacionet e kërkuara në pyetësor. Për këtë qëllim është punuar intesivisht gjithashtu me qëllim të përfundimit të së njëjtës në kohën e kërkuar nga ASK.

VII.3. Aktivitet e Marketingut

Sektori i Marketingut funksionon në kuadër të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit të Trainkos Sh.A. dhe merret kryesisht me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientë, mbajmë kontakte dhe realizojmë vizita të vazhdueshme me klientët e rregullt, prezantojmë shërbimet e Trainkos Sh.A. duke realizuar vizita drejt klientëve potencial, pranimin e kërkesave të transportit, procedimin e kërkesave drejt të gjithë partnerëve tanë vendor dhe ndërkombëtarë si dhe procedimin e ofertave drejt të gjithë klientëve.

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut.

Sektori i marketingut në vitin 2024 ka menaxhuar me rreth 10,000.00 Euro buxhet të shpenzimeve në nivel të shitjeve tek të cilat kemi planifikuar të hyra rreth 1,150.000.00 Euro, që nënkupton se shpenzimet e marketingut kanë marrë pjesë me vetëm 0.86 % në totalin e të hyrave të realizuara. Sektori i marketingut paraprakisht harton planin vjetor të sektorit të marketingut për t'i parashtruar objektivat dhe strategjitë që do ti zhvilloj gjatë vitit 2025 krahas aktiviteteve në fushën e përditshme – rutinore si dhe në fushën propaganduese – mediave që zhvillohen në këtë sektor bazuar në Planin e Biznesit të Trainkos Sh.A.

Krahasuar me vitin paraprak sektori i marketingut në vitin 2025 ka në dispozicion 9,000.00 Euro buxhet të shpenzimeve për nevoja te promovimit të shërbimeve te Trainkos Sh.A që nënkupton se ka të njëjtën vlerë të mjeteve të disponueshme me pak se në vitin paraprak ku sipas të hyrave nga shitjet e parapara me rishikimin e planit të biznesit në nivel të kompanisë parashihen të jenë rreth 1,000,000.00 Euro përgjatë vitit 2025 që nënkupton se shpenzimet e marketingut kanë marrë pjesë me vetëm 0.90 % në totalin e të hyrave të planifikuara.

Nga klientët vendorë, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, klienti nuk ka vazhduar kontratën. Vlen të theksohet se gjatë takimit të mbajtur në fundvitin e 2024, partneri strategjik 'NewCo Ferronikeli' shprehu interesim të qartë për fillimin e transportit ndërkombëtar të xehe. Megjithatë, materializimi i këtij shërbimi mbeti i porealizueshëm për shkak të kufizimeve infrastrukturore, specifikisht mbylljes së qarkullimit në linjën hekurudhore Hani i Elezit – Leshak, si pasojë e punimeve për rehabilitimin e saj."

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NewCo Ferronikeli	Cemil	Acar	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2025 janë gjithsej tre (3) partnerë. Duhet theksuar këta partnerë që kanë nënshkruar kontratë transporti janë ndërkombëtarë, të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2024, përjashtimisht klineti/partneri Schenker DB dhe Fershped AD.

Më poshtë po ju prezantojmë listën e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NAVICO SHIPPING DOO	Zlatko Crvenkoski	Stefan Stefanovski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2.	CARGO LOGISTC DOO	Zoran Bakraceski	Marjan Veleviski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3.	ARGO LOGISTIC INT	Viktor Tatabitovski	Viktor Tatabitovski	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

Klienti/partneri Shcenker DB dhe Fershped AD nuk kanë nënshkruar kontratë për vitin 2025. Ndërprerja e qarkullimit në segmentin hekurudhor Hani i Elezit – Leshak, si pasojë e procesit të rehabilitimit, pati impakt të drejtpërdrejtë edhe në aktivitetin e partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Në bazë të të dhënave të prezantuara më lartë, Sektori i Marketingut gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 është angazhuar për të realizuar aktivitetet e parapara në Planin Vjetor të Sektorit të Marketingut dhe po ashtu objektivat e përcaktuara nga Plani i Biznesit për vitin 2025.

Sektori i Marketingut ka realizuar kryesisht aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientët e rregull, kemi mbajtur kontakte me klientë dhe me partnerë vendor dhe ndërkombëtarë, kemi pranuar kërkesa për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A, kryesisht për qëllime të xhirimeve (të natyrave të ndryshme) të cilat pas aprovimit i kemi proceduar më tutje. Po ashtu jemi marrë edhe me përgatitjen e ofertave konkrete të udhëtimit me tren për Transport të Udhëtarëve.

Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes tonë në fushën promovuese ne nuk kemi qenë prezent në shumë kanale të marketingut për shkak të kostove shumë të larta dhe kemi shpenzuar në mënyrë sa me optimale të mundshme pasi që edhe kërkesa e DPZHB-së ka qenë që të gjitha shpenzimet e Sektorit të Marketingut të minimizohen për shkak të gjendjes financiare jo të mirë në nivel të kompanisë.

VII.4. Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarive tjera sipas licencës që ka TRAINKOS-i

Gjatë vitit 2025, aktivitetet tona kanë mbetur brenda kufijve minimalë operacionalë, duke mos na lejuar të zgjerohemi në shërbimet tjera që na mundëson licenca (si transporti rrugor, magazinimi , riparimet etj). Sidoqoftë, TRAINKOS Sh.A. ka identifikuar qartë të gjitha mundësitë ligjore dhe operative që posedon. Jemi të përkushtuar që, me krijimin e mundësive, të ndërmarrim hapat e nevojshëm për diversifikimin e shërbimeve, në mënyrë që t'i përgjigjemi kërkesave të sektorit hekurudhor dhe strategjive kombëtare të transportit.

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK - Trainkos - SH.A është si vijon:

Skema Organizative:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK - Trainkos - SH.A. më 01 Janar 2025 dhe më 31 Dhjetor 2025				
Totali i të punësuarve	01.01.2025		31.12.2025	
	173		148	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2025	31.12.2025	01.01.2025	31.12.2025
Mosha mesatare e punëtorëve	48.13 %	48.16 %	%	%
Në marrëdhënie të rregullt pune	173	148	%	%
Meshkuj	149	128	86.12 %	86.48 %
Femra	24	20	13.87 %	13.51 %
Serbë	1	1	0.57 %	0.67 %
Shqiptarë	172	147	99.42 %	99.32 %
Me shkollim fillor	3	2	1.73 %	1.35 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	95	80	54.91 %	54.05 %
Me kualifikim profesional	20	20	11.56 %	13.51 %
Me përgatitje të lartë	2	2	1.15 %	1.35 %
Me përgatitje superiore	53	44	30.63 %	29.72 %
Zyrtarët e Lartë	3	4	1.74 %	2.70 %
Departamenti për Operime Hekurudhore	104	93	60.11 %	62.83 %
Departamenti i Administratës	36	29	20.80 %	19.59 %
Departamenti i Financave	4	3	2.31 %	2.02 %
Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit	11	7	6.35 %	4.72 %
Kabineti i KE-së	2	2	1.15 %	1.35 %
Zyra e Prokurimit	3	2	1.74 %	1.35 %
Njësia e Auditimit të Brendshëm	1	1	0.57 %	0.67 %
Spektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	9	7	5.20 %	4.72 %

Vërejtje: Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë vitit 2025 në Ndërmarrje ka pasur edhe lëvizje/ndryshime të stafit në numrin e përgjithshëm të të punësuarve. Në tabelën në vijim janë përshkruar shkaqet e lëvizjeve që kanë ndodhur/ndikuar në këto ndryshime:

Nr.	Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Total
1	Aktiv në fillimmuaj	173	162	162	159
2	Të pensionuar	1	0	0	1
3	Të larguar/shkarkuar	10	0	2	12
4	Të dorëhequr	0	0	1	1
5	Të punësuar	0	0	0	0
6	Frekuenca në fundmuaj	173	162	162	
7	Aktiv në fundmuaj	162	162	159	

Nr.	Emërtimi	Prill	Maj	Qershor	Total
1	Aktiv në fillimmuaj	159	156	156	160
2	Të pensionuar	0	0	0	0
3	Të larguar/shkarkuar	0	0	0	0
4	Të dorëhequr	3	0	0	3
5	Të punësuar	0	0	4	4
6	Frekuenca në fundmuaj	159	156	160	
7	Aktiv në fundmuaj	156	156	160	

Nr.	Emërtimi	Korrik	Gusht	Shtator	Total
1	Aktiv në fillimmuaj	160	153	149	146
2	Të pensionuar	2	3	0	5
3	Të larguar/shkarkuar	1	0	0	1
4	Të dorëhequr	4	2	3	9
5	Të punësuar	0	1	0	1
6	Frekuenca në fundmuaj	160	154	149	
7	Aktiv në fundmuaj	153	149	146	

Nr.	Emërtimi	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1	Aktiv në fillimmuaj	146	147	149	148
2	Të pensionuar	2	0	0	2
3	Të larguar/shkarkuar	0	0	0	0
4	Të dorëhequr	2	1	1	4
5	Të punësuar	5	3	0	8
6	Frekuenca në fundmuaj	151	150	149	
7	Aktiv në fundmuaj	147	149	148	

Në bazë të të dhënave në tabelën më lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.01.2025 ka qenë 173, ndërsa me datën 31.12.2025 ka qenë 148 punëtorë.

IX. PROCEDURAT GJYQËSORE

IX.1. Kontestet gjyqësore

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2025 nga Zyra Ligjore e Ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Në tabelën më poshtë do të paraqesim seancat e mbajtura, veprimet që janë ndërmarrë në cilësinë e paditësit, të paditurit, kreditorit dhe debitorit, si dhe aktgjykimet e gjykatave.

	Përshkrim	Vlera në €
1.	Gjatë këtij viti janë mbajtur 28 seanca: C.nr.76/14, KE.nr.634/23, C.nr.609/21, KE.nr.229/23, C.nr.3500/14, C.nr.184/23, KE.nr.634/23, KE.nr.531/23,3763/17,C.nr.184/23,KE.nr.531/23,C.nr.184/23,C.nr.184/23,C.nr.609/21, P.nr.3763/17, KE.nr.531/23, C.nr.609/21, C.nr.140/25,57PL1-TS-1105/24, P.nr.3763/17,C.nr.154A/23, C.nr.154A/23, C.nr.4645/25, C.nr.302/16, C.nr.154A/23, C.nr.302/16, C.nr.724/17, C.nr.463/10 dhe kemi pranuar 16 thirrje për seanca.	
2.	<p>Me datë 06.01.2025 kemi pranuar parashtresë me precizim të kërkesë padisë nga Av.Msc.V. K., në lëndën kompensim dëmi C.nr.609/21, paditës R. L., të paditura: Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A, etj. Me datë 07.02.2025 në Gjykatën Themelore në Pejë është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor në lëndën kompensim dëmi C.nr.609/21, paditësi R. L., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., etj. Gjatë seancës ne si palë e paditur në bazë të përgjigjes në padi dhe në bazë të ekspertizës së komunikacionit e cila fajtor e nxjerrë paditësin, ne kemi kërkuar nga gjykata që mos të jemi më palë në procedurë. Me datë 26.02.2025 nga Gjykata Themelore në Pejë kemi pranuar ekspertizën e komunikacionit nga eksperti ING L.L.C. Sejdi Berisha ekspert i komunikacionit dhe makinerisë, në lëndën C.nr.609/21, paditës R.L., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., etj, ku eksperti ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur nga lëshimet solidare nga këta tre faktorë: Ngasësi i automjetit, Komuna e Pejës dhe Infrakos - Sh.A.</p> <p>Me datë 05.05.2025 në Gjykatën Themelore në Pejë kemi marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor në lëndën kompensim dëmi C.nr.609/21, paditës R. L., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., etj. Pas deklarimit të paditurve është vazhduar me procedurën e provave dhe me pyetjet ndaj ekspertit të komunikacionit Sejdi Berisha. Pas përfundimit të pyetje - përgjigje gjykata merr Aktvendim që seanca e radhës do të caktohet pasi që Gjykatës ti arrij plotësim ekspertiza dhe palët do të njoftohen në mënyrë të rregullt.</p> <p>Me datë 19.05.2025 nga Eksperti financiar gjyqësor Ukë Sadiku – ecc, diplomuar kemi pranuar plotësim të ekspertizës financiare në lëndën kompensim dëmi C.nr.609/21, paditës R. L., të paditura Hekurudhat e</p>	9,900.00€

	<p>Kosovës - Trainkos - Sh.A., etj. Bashkangjitur ekspertizës financiare nga Gjykata Themelore e Pejës kemi pranuar thirrje për seancë po në këtë lëndë me datë 16.06.2025 në ora 10:00.</p> <p>Me datë 16.06.2025 në Gjykatën Themelore në Pejë kemi marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor në lëndën kompensim dëmi C.nr.609/21, paditës R. L., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., etj. Pas deklarimit të paditurve është vazhduar me procedurën e provave dhe me pyetjet ndaj ekspertit të komunikacionit Sejdi Berisha. Pas përfundimit të pyetje - përgjigje gjykata merr Aktvendim që seanca e radhës do të caktohet pasi që gjykatës ti arrij plotësim ekspertiza dhe palët do të njoftohen në mënyrë të rregullt.</p> <p>Me datë 19.06.2025 nga Av.V. K. kemi pranuar parashtrësë me precizim të kërkesë padisë në lëndën kompensim dëmi C.nr.609/21, paditës R.L., të paditura Trainkos - Sh.A., etj.</p> <p>Me datë 21.07.2025 nga Gjykata Themelore në Pejë kemi pranuar Aktgjykim C.nr.609/21 në lëndën kompensim dëmi, paditës R.L., e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A. etj. Refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesë padia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Trainkos - Sh.A., solidarisht që paditësit të ia paguaj shumat të cilat ka kërkuar.</p> <p>Me datë 07.08.2025 nga R. L. të cilin e përfaqëson av. V. K., kemi pranuar Ankesë kundër Aktgjykimit C.nr. 609/21 e datës 09.07.2025 të Gjykatës Themelore në Pejë.</p>	
3.	<p>Me datë 06.01.2025 nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar thirrje për shqyrtimin gjyqësor në lëndën kompensim dëmi C.nr.3500/14, paditës Familja. J. etj, të paditura Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., dhe Infrakos - Sh.A., me datë 18.02.2025 në ora 13:30.</p> <p>Me datë 18.02.2025 është mbajtur seancë në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën kompensim dëmi C.nr.3500/14, paditës familja J, të paditura Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A., dhe Infrakos - Sh.A., ku pala paditëse nuk ka qenë prezente në sallë por ka dorëzuar parashtrësën në gjykatë me datë 18.02.2025 për tërheqjen e padisë. Duke parë që paditësit me parashtrësë e kanë hequr padinë në këtë çështje juridike dhe të paditurit e japin pëlqimin e tyre për tërheqjen e padisë së paditësve, ndaj gjykata sipas dispozitës së nenit 261 par.2 të LPK-së merr Aktvendim ku konstatohet tërheqja e padisë së paditësve ndaj të paditurve lidhur me këtë çështje do të vendos me Aktvendim të veçantë dhe palët do të njoftohen brenda afatit ligjor.</p> <p>Me datë 26.02.2025 nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar aktvendim në lëndën kompensim dëmi C.nr.3500/14, në çështjen juridike të paditësve Familja J etj, të paditura Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., dhe Infrakos - Sh.A., Aktvendim, konstatohet tërheqja e padisë së paditësve</p>	10,000.00 €

	duke qenë se paditësit e kanë tërhequr padinë dhe të paditurat e kanë dhënë pëlqimin e tyre për tërheqjen e padisë, lënda shkon në a/a.	
4.	Me datë 06.01.2025 nga Gjykata Themelore në Pejë kemi pranuar Aktvendim ku konsiderohet e tërhequr padia e datës 03.09.2020, me numër C.nr.1051/20, e paditësit T. D nga Komuna e Pejës, kundër të paditurës Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., me objekt kontesti kompensim dëmi dhe me vlerë të kontestit 15.000 euro.	15,000.00 €
5.	<p>Me datë 06.01.2025 nga Gjykata Themelore në Glllogoc kemi pranuar thirrje për shqyrtimin kryesor në lëndën kompensim dëmi C.nr.79/14, paditës Familja M, të paditura: Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., me datë 17.01.2025 në ora 09:30. Bashkangjitur kemi pranuar përgjigje në padi nga Komuna e Glllogocit.</p> <p>Me datë 17.01.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega e Gjykatës Glllogoc është mbajtur seancë në lëndën kompensim dëmi C.nr.79/14, paditës familja M., të paditura: 1. Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., 2. Hekurudhat e Kosovës - Infracos - Sh.A., 3. Komuna e Glllogocit, 4. KEDS nga Prishtina. Pas deklaratave të përfaqësuesve i autorizuari i paditësve gjatë deklarimit i propozon Gjykatës dëshmitar kyq për rastin e ndodhur, gjithashtu gjykatës i propozon që të bëhet nxjerrja me anë të grupit të ekspertëve të komunikacionit rrugor dhe që gjykata sipas detyrës zyrtare ta dërgoi lëndën në Fakultetin Teknik dhe që të njëjtit kanë për detyrë që të caktojnë rrethanat e aksidentit. Gjykata merr Aktvendim: Aprovohet propozimi për dëgjimin e njërit nga dëshmitarët, ndërsa sa i përket provës me anë të ekspertizës nga grupi i ekspertëve, Gjykata do të vendos me Aktvendim të veçantë.</p> <p>Me datë 13.02.2025 nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc në lëndën kompensim dëmi C.nr.79/14, paditës Familja M, të paditura 1. Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A., kemi pranuar Aktvendim ku aprovohet propozimi i paditësve për nxjerrjen e provës me ekspertizë të lëmisë së komunikacionit hekurudhor, për ekspert caktohet grupi ekspertëve nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës të cilët do të caktohen me vendim të Dekanit.</p>	66,000.00 €
6.	Me datë 06.01.2025 kemi pranuar nga Gjykata Supreme e Kosovës Aktgjykim në lëndën kontest pune REV.nr.213/24, paditës I. T., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A. Aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurës, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1874/16 i datës 12.06.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.999/12 i datës 05.01.2016 ndryshohet si vijon: Refuzohet si e pabazuar kërkesë padia e paditësit.	31,161.32 €

7.	<p>Me datë 06.01.2025 nga Gjykata Komerciale në Prishtinë kemi pranuar Thirrje për seancën e shqyrtimit kryesor e cila do të mbahet në Gjykatë me datë 28.01.2025 në ora 09:00, baza juridike e kontestit: Pasurim i pabazë KE.nr.634/23, paditës Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., kundër të paditurit Rail Pro Sh.P.K., bashkangjitur kemi pranur dhe Ekspertizë Financiare të punuar nga Agim Sheqiri.</p> <p>Me datë 28.01.2025 në Gjykatën Komerciale në Prishtinë është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor në lëndën e kontestit Pasurim i pabazë KE. nr. 634/22, paditësi Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Rail Pro Shpk.</p>	47,311.49 €
8.	<p>Me datë 20.01.2025 nga Gjykata Komerciale në Prishtinë kemi pranuar thirrje për seancën e shqyrtimit kryesor në lëndën kompensim dëmi KE. nr. 229/23, paditësi Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Kompania e Sigurimit Fizik “Luani” SHPK. Seanca mbahet me datë 10.02.2025 në ora 10:00.</p> <p>Me datë 10.02.2025 është mbajtur seancë në Gjykatë Komerciale në Prishtinë në lëndën kompensim dëmi KE.nr.229/23, paditëse Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Kompania e Sigurimit Fizik “Luani” Sh.p.k., ku gjatë seancës gjykata merr Aktvendim që të lexohen provat dhe të kalohet në fjalën përfundimtare ku pala paditëse Trainkos - Sh.A., fjalën përfundimtare e dorëzon në formë të shkruar.</p> <p>Me datë 03.03.2025 nga Gjykata Komerciale e Kosovës kemi pranuar Aktgjykim KE. nr. 229/22 në lëndën kompensim dëmi, paditës Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Kompania e Sigurimit Fizik “Luani” Sh.p.k., në Aktgjykim Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesë padia e paditësit Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datë 07.03.2025 kemi parshtruar Ankesë në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhoma e Shkallës së Dytë, Departamenti për Çështje Ekonomike kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë – Dhoma e Shkallës së Parë KE. nr. 229/22, në lëndën kompensim dëmi, paditëse Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Kompania e Sigurimit Fizik “Luani” Sh.p.k.</p> <p>Me datë 12.03.2025 kemi pranuar ankesë nga Av. Labinot Buzuku me autorizim nga Kompania e Sigurimit Fizik Luani Sh.p.k., drejtuar Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike për Dhomën e Shkallës së Dytë, paditëse Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Kompania e Sigurimit Fizik Luani Sh.p.k., në lëndën kompensim dëmi KE. nr. 229/23</p>	16,703.00 €
9.	<p>Me datë 29.01.2025 nga Gjykata Themelore në Pejë kemi pranuar thirrje për seancë gjyqësore në lëndën kompensim dëmi C. nr. 184/23, paditësi G. B., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datë 20.02.2025 është mbajtur seancë në Gjykatën Themelore në Pejë</p>	

	<p>në lëndën kompensim dëmi C. nr. 184/23, paditës G. B., e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A., ku gjatë seancës kemi deklaruar që meqenëse ekspertiza nuk na lenë neve fajtor kemi kërkuar që pala paditëse të bëjë tërheqjen e padisë ndaj Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datë 03.03.2025 kemi pranuar Parashtresë me precizim të Kërkesë padisë nga Avokati Mustafë Kastrati i autorizuari i paditësit G.B. në lëndën C.nr.184/23, të paditura Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., Infrakos - Sh.A., Ministria e Infrastrukturës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave dhe Komuna e Pejës.</p>	4,500.00€
10	<p>Me datë 12.03.2025 nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë kemi pranuar Aktgjykim në lëndën me nr. Ac. nnr. n 986/2022 në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.G., kundër të paditurës HK - Trainkos - Sh.A., me objekt të kontestit kompensimin e shpërblimit jubilar.</p> <p>Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit R.G. nga fshati Studime e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C. nr. 4460/20 i datës 21.09.2021 vërtetohet.</p>	1,170.00€
11	<p>Me datë 12.03.2025 nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar Aktvendim në çështjen juridike kontestimore C. nr. 522/2024, të paditëses A. S. nga Prishtina, kundër të paditurës Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Detyrohet e paditura HK - Trainkos - Sh.A., që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë, t'ia paraqes gjykatës përgjigjen në padi, në formë të shkruar në tre ekzemplar, nën kërcenim të pasojave procedurale.</p> <p>Kemi përgatitur përgjigje në padi në çështjen juridike kontestimore C. nr.522/2024, paditëse A.S., e paditur HK - Trainkos - Sh.A, ku sipas Gjykatës Themelore në Prishtinë duhet të japim përgjigje në formë të shkruar në tre ekzemplar në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë.</p>	
12	<p>Nga Gjykata Supreme e Kosovës me datë 22.04.2025 kemi pranuar Aktvendim Rev. E.nr. 42/2024 në çështjen juridike të paditësit N.T.SH. "Etika", kundër të paditurës Trainkos - SH.A., për shkak të kompensimit të dëmit duke vendosur sipas revizionit të paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1482/2022. Gjykata ka marrë aktvendim ku hidhet si i pa lejuar revizioni i paditësit N.T.SH. "Etika".</p>	30,553.78 €
13	<p>Me datë 19.05.2025 kemi pranuar Aktvendim nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, në lëndën kompensim dëmi Ac. nr. 6038/2022, paditës H. Sh., e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurës Trainkos - Sh.A., me seli në</p>	21,000.00

	<p>Fushë Kosovë, prishet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm C. nr. 155/14, i datës 27.05.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës në rigjykim dhe rivendosje.</p>	€
14	<p>Me datë 02.07.2025 nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë kemi pranuar Aktgjykim Ac. nr.666/2022, paditëse Familja Q, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A. Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Trainkos - Sh.A., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C. nr. 724/17, i datës 05.11.2021 vërtetohet.</p> <p>Me datë 30.07.2025 kemi dërguar revizion në Gjykatën Themelore në Pejë për Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë, në lëndën C. nr. 724/17, paditëse familja Q, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datë 07.08.2025 nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj kemi pranuar propozim për përmbartim në lëndën Familja Q, nr. 609/25 i datës 25.07.2025, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A.</p> <p>Me datë 11.08.2025 kemi dërguar prapësim kundër urdhërit përmbartimor përmbartuesit privat Destan Bujupaj për Gjykatën Themelore në Prishtinë, në lëndën përmbartimore P. nr. 609/25, paditës Familja, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datë 25.08.2025 nga Gjykata Themelore në Pejë kemi pranuar vërejtje për taksë gjyqësore për revizion në vlerë 40 euro në lëndën C. nr. 724/17, paditës Familja Q, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A. dhe është paguar taksa sipas fletëdërgesës nga Gjykata.</p> <p>Me datë 28. 08.2025 nga përmbartuesi privat Destan Bujupaj kemi pranuar Konkluzion ku për ekspert financiar caktohet Emin Plakaj në lëndë përmbartimore P.nr.609/25, Kreditor Familja Q, bashkangjitur kemi pranuar edhe ekspertizën financiare e punuar nga Eksperti Financiar Emin Plakaj.</p> <p>Me datë 18.11.2025 kemi dorëzuar Propozim për caktimin e Masës së Sigurisë për Gjykatën Themelore në Pejë në lëndën kompensim demi me numër A.c. nr. 666/2022, paditës Familja Q, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datën 09.12.2025 nga Gjykata Supreme e Kosoves kemi pranuar</p>	83,001.97 €

	<p>Aktevendim në lëndën C. nr. 724/17, paditës Familja Q, e paditur Hekurudhat e Kosovës -Trainkos -Sh.A., pranohet revizioni i të paditurës Hekurudhat e Kosovës -Trainkos Sh.A., prishet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë dhe çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.</p> <p>Me datën 09.12.2025 nga Gjykata Themelore në Pejë kemi pranuar thirrje për seancë në lëndën C. nr. 724/17, paditës Familja Q, e paditur Hekurudhat e Kosoves - Trainkos Sh.A., e cila do të mbahet me datën 18.12.2025 në ora 9:00.</p> <p>Më datën 18.12.2025 kemi marrë pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë, në lëndën C. nr. 724/17, palë Familja Q, ku është bërë prezantimi për caktimin e masës së sigurisë. Gjatë prezantimit Gjykata i ka dorëzuar drejtpërdrejtë në seancë propozuesit të sigurimit Trainkos - Sh.A. një kopje të përgjigjes në kundërshtim.</p>	
15	<p>Me datë 16.09.2025 kemi pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – dega në Fushë Kosovë – Departamenti Civil, thirrje për shqyrtim gjyqësor për çështjen juridike të propozuesit Sh. S. të cilin e përfaqëson Av. Qendrim Arifaj, për Anulim Vendimi kundër propozuesit Trainkos - Sh.A., që me datë 09.10.2025 në ora 11: 00 të paraqitet në Gjykatë.</p> <p>Me 09.10.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Fushë Kosovë është mbajtur seancë në lëndën C. nr. 154A/23 padites Sh. S, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A .Gjykata merr aktvendim se në shkresat e lëndës nuk ka deshmi se të paditurës i është dorëzuar aktvindimi për përgjigjen në padi së bashku me shkresat e lëndës, andaj Gjykata një kopje të saj së bashku me provat ia dorëzon të autorizuares së paditurës dhe Gjykata seancën e sotme e shtynë për datën 22.10.2025 në ora 14.00.</p> <p>Me datën 22.10.2025 nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Fushë Kosovë është mbajtur seanca në lëndën C .nr 154A/23, paditës Sh. S, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A. Gjatë marrjes pjesë në seancë kemi pranuar bashkimin e dy lëndëve me të cilën kemi kthyer përgjigje në padi në lëndën C. nr. 615A/23.</p> <p>Me datë 18.11.2025 kami marrë pjesë në seancë në Gjykatën Themelore në Fushë Kosovë në lëndën kontest pune C .nr. 134A/23, paditës Sh. S, e paditur Hekurudhat e Kosoves - Trainkos - Sh.A., ku pala paditëse gjatë deklarimit i propozon Gjykatës të cakton një ekspert nga lëmia Financiare dhe propozon për dëgjimin e dëshmitarit A. P. për vendimin 492 në të cilën ka qënë anetar i Komisionit për Ankesa. Nga ana jonë është mbrojtur përgjigja në padi dhe</p>	5,000.00€

	<p>Gjykata Themelore në Fushë Kosovë në aktvendim deklaroi që pas marrjes së Ekspertizës Financiare do ta caktoi edhe seancën e radhës.</p> <p>Me datë 30.12.2025 kemi pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – dega në Fushë Kosovë – Departamenti Civil, thirrje për shqyrtim gjyqësor për çështjen juridike të propozuesit Sh. S. të cilin e përfaqëson Av. Qendrim Arifaj për Anulim Vendimi, kundër propozuesit Trainkos - Sh.A., që me datë 19.01.2026 në ora 09:30 të paraqitet në Gjykatë. Së bashku me ftesë kemi pranuar edhe ekspertizën financiare.</p>	
16	<p>Me datë 24.09.2025 kemi marrë pjesë në seancë në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, në lëndën P. nr. 3763/17 vepër penale nga neni 327/1, e dëmtuar Trainkos - Sh.A., i pandehur Sh.H. Seanca shtyhet për një datë tjetër për arsye se nuk po gjinden adresat e të pandehurve.</p>	
17	<p>Me datë 26.09.2025 nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë kemi pranuar aktgjykim Ac .nr. 5296/2022, paditës Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A. dhe Komuna e Ferizajt, ku aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e paditësve.</p> <p>Me datë 26.09.2025 nga Av. Zekrija Gashi kemi pranuar Urgjencë e të autorizuarit nga Ferizaj për aktgjykimin e plotfuqishëm C. nr. 2019: 164006, të paditësve Familja G, ndaj të paditurve Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A. dhe Komuna e Ferizajt.</p> <p>Me datën 24.10.2025 kemi dërguar në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë Revizion në lëndën C.nr.463/10 paditës Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - SHA.</p> <p>Me datën 27.10.2025 kemi pranuar propozim për përmbarim – urdhërin përmbarimor P. nr. 446/2025 nga Përmbaruesi privat Sheremet Livoreka për familjen G.</p> <p>Me datën 31.10.2025 kemi dërguar Prapësim të Përmbaruesi privat Sheremet Livoreka për Gjykatën Themelore në Ferizaj në lëndën P. nr. 446/2025, paditëse Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Kemi dorzuar Propozim për caktimin e Masës së Sigurisë për Gjykatën Themelore në Ferizaj, në lëndën kompensim dëmi me numër A c. nr.5296/2022, paditës Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Me datën 01.12.2025 nga Gjykata Themelore në Ferizaj kemi pranuar Aktvendim në lëndën C. nr. 330/25, paditës Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. ftohet propozuesi Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., që në afat prej 3 ditësh ta plotësoj precizoj propozimin për caktimin e masës duke përcaktuar kërkesën e masës dhe llojin e masës në qoftëse kthehet e pakorigjuar do të hedhet poshtë padia.</p> <p>Me datë 03.12.2025 kemi dorëzuar Precizim për Masë të Sigurisë për Gjykatën Themelore në Ferizaj në lëndën C. nr. 330/25, paditës Familja G, e</p>	51,433.00 €

	<p>paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A.</p> <p>Më datën 19.12.2025 kemi pranuar ftesë për seancë në lëndën e kompensimit të dëmit me numër C. nr. 463/10, paditës Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës – Trainkos - Sh.A.. Jemi thirrur si propozues për masën e sigurisë me datë 22.12.2025 në ora 09:30.</p> <p>Më datën 22.12.2025 kemi marrë pjesë në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në lëndën C. nr. 463/10, palë Familja G. Gjykata e hapi seancën duke konstatuar se për të paditurin/kundërpropozuesin ekzistojnë prova se të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo asnjëri prej tyre nuk ishte i pranishëm në seancë dhe nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë apo njoftim për shtyrjen e saj. Seanca u mbajt në mungesë të palës kundërpropozuese, ndërsa ne u deklaruam se qëndrojmë pranë propozimit për caktimin e masës së sigurisë me qëllim të mbrojtjes së shumës së kontestuar në të holla.</p> <p>Me datë 30.12.2025 nga Gjykata Themelore në Ferizaj kemi pranuar Aktvendim C. nr. 330/25 në lëndën kompensim dëmi, paditëse Familja G, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A. Refuzohet propozimi i propozueses HK - Trainkos - Sh.A., për caktimin e masës së sigurimit.</p>	
18	<p>Me datë 26.09.2025 nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë kemi pranuar aktvendim CA. nr. 13324/2025, paditëse N. D, e paditur Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., ku aprovohet si e themeltë ankesa e propozuesit Trainkos - Sh.A., dhe priset Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm C. nr. 1969/2018, i datës 11.10.2024 dhe lënda i kthehet të njëjtës Gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.</p> <p>Me 28.10.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca në Lëndën C. nr. 4645/25 Propozuese Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - Sh.A. Kunderpropozues N.D.</p> <p>Nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Depërtamenti i Përgjithshëm kemi pranuar Aktvendim në lëndën C. nr. 4645/25 në çështjen juridike sipas propozimit të propozuesit Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., kundër kundështarit të sigurimit N. D., për caktimin e masës së sigurisë caktohet Garancioni për sigurimin e lëndës detyrohet Trainkos - Sh.A., në afat prej 7 ditëve në xhirollogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të deponoj 10,000.00€, në të kundërtën Gjykata do ta refuzoi Propozimin për caktimin e masës së sigurisë.</p>	71,290.52 €
19	<p>Me datën 27.10.2025 kemi pranuar Aktgjykim në lëndën KE. nr. 531/23 paditëse Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., e paditur Railtrans nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.</p> <p>Me datën 31.10.2025 kemi dërguar Ankesë në Gjykatën Komerciale në Prishtinë –dhoma e shkallës së parë për Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Dhoma e shkallës së dytë në lëndën KE. nr. 531/23 paditese Hekurudhat e</p>	

	<p>Kosovës Sh.A., e paditur “Railtrans”</p> <p>Me datë 19.11.2025 nga Gjykata Komerciale e Kosovës kemi pranuar Ankesë nga i autorizuari Av. A.D, i të paditurit Railtrans L.L.C., ku me vendimin e Gjykatës Komerciale Dhoma e shkallës së parë e ka kthyer në favor të Kompanisë ku ne jemi palë paditëse.</p>	
	<p>Me datën 05.11.2025 kemi pasur seancë në Gjykatën Themelore në Klinë në lëndën C. nr. 302/16 të P. C., mirëpo seanca nuk është mbajtur por është shtyer me datën 04.12.2025.</p> <p>Me datën 04.12.2025 kemi marrë pjesë në seancë në Gjykatën Themelore në Klinë, në lëndën përmbaremore C. nr. 302/16, paditës P.C, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos - Sh.A., gjatë prezantimit nga përfaqësuesi i palës paditëse kemi pranuar parashtrësë për kundërshtim të ekspertizës e cila ka ardhur në favor të Kompanisë. Gjykata merr Aktvendim që në seancën e radhës është caktuar me datën 23.01.2026 në ora 13:10 dhe kjo vlenë në vend të ftesës.</p>	
	<p>Me datën 01.12.2025 nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm kemi pranuar Aktvendim në lëndën përmbaremore PP. nr. 49/2023, kreditor Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., kundër debitorit NT Herolindi ku sipas Gjykatës përfundohet procedura përmbaremore nëse në afat prej 6 muajsh kreditori nuk paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar.</p>	

Tabela 8.1

IX.2. Tabela e kontesteve gjyqësore

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., gjatë vitit 2026 pritet të ballafaqohen me **63** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	//////////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	13
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	25
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	4
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbaremore	19
6.	Lëndë në procedurë penale	1
	Totali	63

Tabela 8.2

X. PËRFUNDIM

HK-Trainkos Sh.A gjatë vitit 2025, përkundër përpjekjeve e angazhimit, nuk ka arritur që të përmbush planifikimet dhe objektivat e përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Pengesat kanë qenë nga më të ndryshmet, probleme të vjetra e të shumta janë bërë pengesë në realizimin e planifikimeve dhe në zhvillimin e Ndërmarrjes.

Megjithatë, përkundër të gjitha vështirësive, disa prej sukseseve të arritura nga masat e ndërmarra gjatë këtij viti janë premtuese për Ndërmarrjen, të domosdoshme po ashtu kanë qenë për tejkalimin e gjendjes së vështirë të saj. Shkurtime buxhetore dhe shfrytëzimi racional i resurseve tjera të Ndërmarrjes, kanë ndikuar në shkallë të lartë në sanimin e gjendjes dhe zvogëlimin e shpenzimeve në vitin 2025.

Pengesat që janë shfaqur nga realizimi i projektit në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore pothuajse janë afër tejkalimit, këtë vit presim sikur në vitet paraprake që Linja e Hanit të Elezit të jetë e gatshme për operim. Me fillimin e transportit hekurudhor në këtë linjë për Trainkos-in do të hapen mundësi të reja, por njëkohësisht do të shtohen edhe sfidat.

Gjendja e mjeteve lëvizëse hekurudhore të Ndërmarrjes, të cilat janë të vjetruara e të pakta në numër, padyshim që rrisin kërkesën dhe nevojën për ripërtëritjen e tyre. Procesi i avancimeve në sistemin hekurudhor me planifikimet strategjike për kontinentin nga BE-ja për funksionalizimin e tërë Rrjetit Bazik Hekurudhor të Evropës dhe kërkesat që vijnë nga nevoja për reformim të këtij sistemi në Evropën Jug Lindore kërkojnë përgatitje adekuate për ndërmarren, përfshirë edhe mjete lëvizëse hekurudhore sipas standardeve. Plotësimi i kriterëve të Interoperabilitetit përmes TSI dhe plotësimi i kriterëve/kërkesave që vijnë përmes Planit të Veprimit për Mekanizmin Stabilizim Asociim (PVMSA) dhe kërkesat tjera që Trainkos-i duhet t'i plotësojë si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhor të Republikës së Kosovës, kjo është dhe do të jetë sfiduese.

Besojmë se me mbështetjen edhe të Aksionarit, do të gjejmë rrugë e mundësi për investime në mjetet lëvizëse, qoftë përmes granteve apo investimeve përmes formave tjera të financimit nga institucionet financiare.

Përkushtimi i përhershëm mbetet në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të Ndërmarrjes në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve tona për klientët tanë.

Fushë Kosovë,

Shkurt 2026

**Agron Statovci**
Kryeshf Ekzekutiv